



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 801/2024

Data e vendimit: 13.09.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "Vb Holding" Sh.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qendrës Multifunksionale në qytetin e Lipjanit" me numër të prokurimit "613-24-8840-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan, zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit z.Agim Sheqiri me datën 13/09/2024, mori këtë:

VENDIM

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e Vb Holding Sh.P.K. me nr. të protokollit 2024/0801, e datës 05/09/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qendrës Multifunksionale në qytetin e Lipjanit" me numër të prokurimit "613-24-8840-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan.

II.I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal Lipjan që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i qendrës Multifunksionale në qytetin e Lipjanit" me numër të prokurimit "613-24-8840-5-1-1", përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 05.09.2024, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE Vb Holding Sh.P.K. për aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i qendrës Multifunkionale në qytetin e Lipjanit” me numër të prokurimit “613-24-8840-5-1-1”, iniciuar nga Kuvendi Komunal Lipjan në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimi të ankesave pas pranimi të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 06.09.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur ne platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet ne paragrafin 2 te nenit 69 te rregullores 001/2022 te prokurimit publik. citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur te na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën **në të kundërtën Ankesa do të refuzohet.** Për të cilën OE ankues lidhur me e-mailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE. “Vb Holding” Sh.P.K. e datës 05.09.2024 (protokoll 0801/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i qendrës Multifunkionale në qytetin e Lipjanit” me numër të prokurimit “613-24-8840-5-1-1”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Lipijan, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues –Kuvendi Komunal Lipijan që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i qendrës Multifunkionale në qytetin e Lipjanit” me numër të prokurimit “613-24-8840-5-1-1”, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të

veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Lipjan

1x1 OE. "Vb Holding" Sh.P.K.

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri
Ud. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

